

Vendim nr. 98 datë 08.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Fiona Papajorgji,	Anëtare

në datën 08.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (Gj) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJON GJEGJI

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga pika 2 e nenit 399/7 të Kodit të Procedurës Civile të rekursit të regjistruar me nr. 71008-00661-00-2016, datë 19.04.2016 dhe të vendimit nr. 00-2022-851, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Lartë.
Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-851, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 dhe 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fiona Papajorgji, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Gjon Gjegji jeton në një banesë private, fqinj me shtetasen N.P., në qytetin e Elbasanit. Midis dy familjeve të tyre ka pasur mosmarrëveshje lidhur me pronësinë e një sipërfaqeje toke në posedim të kërkuesit. Me pretendimin se kjo shtetase ka ndërhyrë në këtë sipërfaqe duke prishur gardhin ndarës, shembur muret rrethuese, prerë pemët dhe zaptuar një pjesë të saj duke ndërtuar një shtëpi e re, kërkuesi, në datën 19.04.2012, ka paraqitur kallëzim penal për kryerjen e veprave penale “Shkatërrimi i pronës” dhe “Vetëgjyqësia”, të parashikuara në nenet 150 e 277 të Kodit Penal (KP). Prokurori pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal me nr. 988 të vitit 2012 për këto vepra, duke përditësuar regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe me veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuar në nenin 199/a të KP-së.

2. Me vendimin e datës 22.05.2013 prokurori ka vendosur pushimin e çështjes, në përputhje me nenin 328/1, shkronjat “e” dhe “f” të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1227 (2876), datë 08.05.2014, ka vendosur: “*Rrëzimin e kërkesës*”, vendim i cili është ankimuar nga kërkuesi.

4. Me vendimin nr.10-2016-53(3), datë 18.01.2016, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 1227 (2876), datë 08.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*”. Kundër këtij vendimi, në datën 17.02.2016, ka paraqitur rekurs kërkuesi, ndërsa në datën 27.06.2017 ka paraqitur një shtesë rekursi.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-851, datë 12.07.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me argumentin se nuk përmban asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së.

6. Në datën 23.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimit gjyqësor sipas objektit, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar:

- 7.1. *Të drejtën për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështja e kërkuesit është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 19.04.2016 dhe ka përfunduar në datën 12.07.2022, në tejkalim të afatit 6-mujor të parashikuar nga neni 399/2 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

- 7.2. Të drejtën për t'u njoftuar, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë në lidhje me vazhdimin e gjykimit, përbërjen e trupit gjykues, seancën gjyqësore dhe as për vendimin e arsyetuar, megjithëse ai është interesuar vazhdimisht për fatin e çështjes së tij dhe pavarësisht moshës 74 vjeç.
- 7.3. Të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, pasi një pjesë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës nuk kanë pasur të drejtë të gjykonin çështjen.
- 7.4. Të drejtën për një gjykim të drejtë, pasi të tria gjykatat e kanë konsideruar veprën penale të kallëzuar nga kërkuesi si gjë të gjykuar, kur në fakt ndodhemi përpara një veprë penale të kryer rishtazi.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në drejtim të verifikimit të përmbushjes së këtyre kriterëve, Kolegji vlerëson se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, ndaj ai ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i takon shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të

gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Kolegji vëren se në rastin konkret kërkuesi i është drejtuar Gjykatës, duke i parashtruar asaj dy kërtime në objekt. Kërkimi i parë lidhet me konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të rekursit të regjistruar me nr. 71008-00661-00-2016, datë 19.04.2016 dhe vendimit nr. 00-2022-851, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Lartë. Kërkimi i dytë lidhet me shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-851, datë 12.07.2022 të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, për shkak të cenimit të procesit të rregullt ligjor.

13. Për sa i përket kërimit të parë, që lidhet me cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, pasi çështja e tij është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 19.04.2016 dhe ka përfunduar në datën 12.07.2022, në tejkalim të afatit 6-mujor të parashikuar nga neni 399/2 i KPC-së, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës dhe përmbajtjes së saj, Kolegji konstaton se ai është parashtruar nga kërkuesi drejtpërdrejt përpara Gjykatës, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që ai ka pasur në dispozicion, sipas neneve 399/1 – 399/12 të këtij kodi. Si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit, duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, kërkuesi nuk legjitimohet lidhur me këtë kërkim, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion. Ndërsa në lidhje me kërkimin tjetër, ai nuk ka mjete të tjera për të shteruar përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, për rrjedhojë e plotëson këtë kriter.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Afati 4-mujor fillon të llogaritet nga data e dhënies së vendimit nga organi gjyqësor që përbën mjetin e fundit ankimor, nëse kërkuesi nuk provon se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data e vendimit. Në rastin konkret, vendimi më i fundit i kundërshtuar nga kërkuesi mban datën 12.07.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 23.03.2023. Lidhur me këtë fakt, kërkuesi ka pretenduar se është interesuar vazhdimisht në sportelet e Gjykatës Lartë për të marrë informacion për çështjen dhe i është thënë se është ende në shqyrtim në dhomën e këshillimit. Në datën 08.10.2022 kërkuesi i është

drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për informacion në lidhje me rekursin e paraqitur prej tij. Me shkresën nr. 6061/1, datë 10.11.2022, Gjykata e Lartë i ka komunikuar se “*pas verifikimit të kryer nga ana jonë sot më datë 10.11.2022 në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (CCMIS) të Gjykatës së Lartë, rezulton se nuk ka të regjistruar çështje penale në emrin tuaj*”. Në vijim, në datën 18.11.2022, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për informacion në lidhje me çështjen penale nr. 71008-00661-00-2016 të regjistruar në datën 19.04.2016. Me shkresën nr. 6315/1, datë 25.11.2022, Gjykata e Lartë i ka komunikuar atij bashkëlidhur vendimin nr. 00-2022-851, datë 12.07.2022, objekt kërkesë. Sipas kërkuesit, ky është momenti kur është njohur me vendimin e Gjykatës së Lartë dhe prej nga fillon të ecë afati 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

15. Për sa më lart, nisur nga fakti se, Gjykata e Lartë, gabimisht, i ka komunikuar kërkuesit se nuk rezulton rekurs në emër të tij dhe se individi nuk mund të mbajë një barrë të tepruar për shkak të gabimeve të administratës së gjykatës, Kolegji, vlerëson se, në rastin konkret, data e marrjes dijeni të vendimit është data 18.11.2022. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkesa përmbush edhe kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*.

16. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u njoftuar, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme dhe së drejtës për një gjykim të drejtë.

17. Lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, Kolegji konstaton se kërkuesi e ka paraqitur atë në mënyrë të përgjithshme, duke parashtruar se një pjesë e gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës nuk kanë pasur të drejtë të gjykonin çështjen, por nuk ka sjellë asnjë argument për këtë pretendim. Për rrjedhojë, ai nuk ka arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues. Gjithashtu, edhe në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për një gjykim të drejtë, pasi të tria gjykatat e kanë konsideruar veprën penale të kallëzuar nga kërkuesi si gjë të gjykuar, kur në fakt ndodhemi përpara një veprë penale të kryer rishtazi, Kolegji vlerëson se ai nuk e ka lidhur me ekzistencën e ndonjë procesi gjyqësor të përfunduar, si dhe nuk ka paraqitur argumente kushtetuese të mjaftueshme për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se edhe ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Ndërsa në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar, nisur nga fakti se Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, Kolegji çmon ta trajtojë këtë të drejtë të lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur dhe për t’u dëgjuar.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u njoftuar të lidhur me të drejtën për t’u mbrojtur dhe për t’u dëgjuar

19. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë në lidhje me vazhdimin e gjykimit, përbërjen e trupit gjykues, seancën gjyqësore dhe as për vendimin e arsyetuar, megjithëse ai është interesuar vazhdimisht për fatin e çështjes së tij.

20. Neni 42, pika 2, i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues e ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në kuadër të së drejtës për proces të rregullt ligjor, hyjnë edhe e drejta e mbrojtjes edhe e drejta për t'u dëgjuar, të parashikuara nga nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës. Edhe pse këto të drejta mund të zhvillohen më shumë nga doktrina dhe jurisprudenca në fushën penale, ato janë përsëri të zbatueshme në procesin civil.

21. Kështu, në këtë drejtim, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22, datë 29.09.2022; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata është shprehur se është detyrë e administratës gjyqësore të marrë masat për të kryer njoftimin e palëve ndërgjyqëse, duke theksuar se, gjithashtu, është detyrë edhe e palëve që të ndjekin ecurinë e gjykimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë (*shih vendimet nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 32, datë 22.07.2011; nr. 13, datë 04.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Neni 436 i KPP-së parashikon detyrimin e sekretarisë së gjykatës për të njoftuar palët në këndin e njoftimeve, në faqen elektronike zyrtare të gjykatës, si dhe në adresën elektronike të deklaruar të tyre ose të avokatit, të paktën 30 ditë përpara, për datën dhe orën e gjykimit të çështjes. Në zbatim të këtij parashikimi ligjor është miratuar edhe urdhri i Gjykatës së Lartë nr. 131, datë 02.07.2021 “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”.

23. Në rastin konkret, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje nga vetë kërkuesi, i cili ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës. Referuar të dhënave të publikuara nga Gjykata e Lartë, në rubrikën “Çështje të shpallura në gjykim”, ku pasqyrohen të dhënat e çështjeve për shqyrtim në dhomën e këshillimit, përfshirë datën e shpalljes, numrin e çështjes, palët ndërgjyqëse, bazën ligjore, trupin gjykues, relatorin, datën dhe orën e shqyrtimit, rezulton se çështja e kërkuesit është publikuar në datën 10.06.2022, duke përcaktuar se është parashikuar për shqyrtim në datën 12.07.2022. Për më tepër, nuk rezulton që kërkuesi të ketë paraqitur ndonjë argument ose provë nëse ai ka deklaruar ose ka bërë të njohur për gjykatën një adresë të postës elektronike (*e-mail*) për qëllime të marrjes së njoftimeve edhe në rrugë elektronike, sipas nenit 436, pika 3, të KPP-së ose pikës 5 të urdhrit nr. 131, datë 02.07.2021 të Gjykatës së Lartë “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”.

24. Nga sa më lart, nisur nga fakti se rekursi është paraqitur nga vetë kërkuksi, i cili ka detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së tij dhe njoftimi i shqyrtimit të rekursit është publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, argumentet që atij nuk i është komunikuar informacioni për përbërjen e trupit gjykues, datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, dhe vendimi i arsyetuar, janë të pamjaftueshme për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar në drejtim të së drejtës t’u mbrojtur dhe asaj për t’u dëgjuar. Gjithashtu, kërkuksi nuk ka paraqitur ndonjë argument nëse mungesa e njoftimit e ka penguar atë të paraqiste parashtrime të reja e të paparashtruara më parë, të cilat do të sillnin një rezultat të ndryshëm të zgjidhjes së çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar.

25. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.